



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1534/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH Com Votra me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat B.B., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prizren, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit zyrtarja V.I.Xh., me bazë juridike, heshtje administrative, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.218/22 të datës 15.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.01.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit NTSH Com Votra me seli në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.218/22 të datës 15.09.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale,Dhoma e shkallës së parë, K.A.nr.218/22 të datës 15.09.2023, është Refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH Com Votra me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike, që në afatin e paraparë kohor të nxjerr vendim me shkrim dhe të aprovoj kërkesën si të bazuar, pasi që paditësi i plotëson kushtet për vazhdimin e kontratës, si dhe të obligohet e paditura që ti paguaj shpenzimet procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të: shkeljes së dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që Dhomat e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën e paditësit, ta prish Aktgjykimi e goditur dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike, me datë 01.11.2017 me paditësin NTSH Com Votra me seli në Prizren me përfaqësues G.M. pronar, ka lidhur Kontratë për kryerjen e shërbimit të transportit të automjeteve me mjeteve transportuese (merimangë), e cila kontratë vlen prej datës 01.11.2017 deri 31.10.2018 me mundësi vazhdimi për pëlqimin e dyanshëm. Në përgjigjen e datës 27.05.2019 ndaj kërkesës për vazhdimin e kontratës së punës të subjektit NTSH Com Votra në Prizren me pronar E.A., e paditura Komuna e Prizrenit deklaroi se nuk mund të vazhdohet kontrata sepse kjo drejtori asnjëherë nuk ka të lidhur kontratë me E.A. me nr. biznesi 81010312 e në anën tjetër Komuna sipas kompetencave të saj sipas nevojës bën riorganizimin në mjete bartëse me merimangë.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 05.09.2023, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave, ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilin ka Refuzuar si të pabazuar kërkesëpadin e paditësit NTSH Com Votra me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike, që në afatin e paraparë kohor të nxjerr vendim me shkrim dhe të aprovoj kërkesën si të bazuar, pasi që paditësi i plotëson kushtet për vazhdimin e kontratës, si dhe të obligohet e paditura që ti paguaj shpenzimet procedurale.

Në arsyetim të aktgjykimit, dhoma e shkallës së parë thekson se nuk kemi të bëjmë me heshtje administrative, në kuptim të nxjerrjes se një akti administrativ siç përcaktohet me nenin 3 par.2 të LKA-së, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me shprehje të njëanshme të vullnetit nga paditësi për vazhdimin e kontratës për kryerjen e shërbimit të transportit të automjeteve me mjete transportuese (merimangë), ashtu si është paraparë në kontratë se kontrata mund të vazhdohet me pëlqimin e dyanshëm, gjykata nuk mund ta detyroj asnjëherë palë kontraktuese ta vazhdojë kontratën, sepse vazhdimi i kontratës është çështje e vullnetit të lirë e palëve kontraktuese. E paditura nuk ka shprehur interesim për vazhdimin e kontratës, në përgjigjen e dhënë me datë 27.05.2019.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e Kontratës datës 01.11.2017 dhe përgjigjes datës 27.05.2019 të lëshuar nga e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike, në drejtim të thënies në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejt aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e nenit 3 paragrafi 1.2 të LKA-së, që parasheh:

*Akt administrativ - çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative..*

Kolegji vlerëson se Kontrata e datës 01.11.2017 e lidhur mes dy palëve ndërgjyqëse për periudhën 1 vjeçare me mundësi vazhdimi me pëlqimin e dyanshëm, dhe përgjigja e datës 27.05.2019 e lëshuar nga e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike, nuk mund të konsideron si akte – vendime administrative përfundimtare, ndaj të cilave akte mund të iniciohet konflikti administrativ, dhe nuk kemi të bëjmë me heshtje administrative, kjo për faktin se dispozita e nenit 13 të LKA-së, parasheh:

*Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.*

Një situatë të tillë, ku palët ndërgjyqëse kanë lidhur një kontratë 1 vjeçare për kryerjen e shërbimeve, me mundësi vazhdimi me pëlqimin e të dyja palëve, Kolegji vlerëson se meqë nuk kemi një akt administrativ të nxjerrë në procedurë administrative nga e paditura si organ publik, në rastin konkret nuk mund të pranohen pretendimet e paditësit se kemi të bëjmë me heshtje administrative. Prandaj Kolegji vlerëson se dhoma e shkallës së parë me të drejt ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilën e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, për ta obliguar të paditurën që të nxjerrë një akt administrativ apo vendim përkitazi me vazhdimin e Kontratës datës 01.11.2017.

Kolegji nuk i vlerësoi si të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit/paditësit se dhoma e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar faktin se nuk kemi heshtje administrative dhe se duhet zbatuar neni 46 paragrafi 6 i LKA-së. Sikurse u theksua si më lartë, Kolegji vlerësoi se për ta zbatuar dispozitën e nenit 46 par.6 të LKA-së, duhet paraprakisht konstatuar faktin se organi administrativ nuk ka respektuar dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 apo 2 të LKA-së, që përcakton:

1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.
2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimin të atakuar, Kolegji, konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësorë të dispozitave ligjore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga dhoma e shkallës së parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomta e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1534/23 datë 18.01.2024

Kryetar i kolegjit,  
Krenar Berisha